



## MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis:

**Komuna Hani i Elezit, përfaqësuar nga Rufki Suma, kryetar**

dhe

**Kolegji "UNIVERSUM"- dega Ferizaj, përfaqësuar nga Ardit Berisha, drejtor i degës**

**Qershor 2020- Tetor 2020**

### Qëllimi i Memorandumit

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që të bashkëpunojnë në lehtësimin e mundësive për studime universitare për studentët nga Komuna Hani i Elezit, që do të studiojnë në Kolegjin Universum.

### Pika 1

Kolegji Universum, do të ndajë 3 bursa të plota trevjeçare 100% për maturantët gjimnazit "Dardania" si dhe zbritje prej 50% të çmimit të studimeve për të gjithë maturantët dhe të interesuarit për studime nga Hani i Elezit. Këto bursa 50% vlejné për programet: Shkenca Politike, Biznes dhe Menaxhment, Shkenca Kompjuterike, ndërsa për programet e tjera mjekësore për shkak të çmimit më të lartë të studimeve, do të ofrohen zbritje prej 35%.

### Pika 2

Kolegji Universum do të ofroj transportin e rregullt për të gjithë maturantët që na vizitojnë në fazën e regjistrimeve, gjatë qershorit dhe korrikut, dy herë në javë, e hënë de e enjte, ora 13:00, nisja për Ferizaj para ndërtesës së Komunës.

### Pika 3

Komuna Hani i Elezit dhe Kolegji Universum dakordohen se kjo marrëveshje e mirëkuptimit nuk ka asnjë implikim financiar të drejtpërdrejt për t'u paguar apo transferuar nga asnjëra palë.

### Pika 4

Komuna e Hanit të Elezit do të bëjë publikimin e njoftimit për këtë mundësi në faqen e vet zyrtare dhe të ofrojë përmes DKA-së informata shtesë për maturantët, në bashkëpunim dhe koordinim me administratën e Kolegjit Universum.

### Pika 4

Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe si komunikim i ndërsjelltë me besueshmëri të plotë.

Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna të ndonjërës palë për qëllime tjera, pa dakordim dhe aprovim paraprak.

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hani i Elezit, më datë: 18.06.2020

PALET NËNSHKRUESE

**Komuna Hani i Elezit**

**Rudri Suma, kryetar**



**Kolegji 'Universum'**

**Ardit Berisha, drejtor**

